



Raport i punës së Kuvendit për periudhën Janar- Dhjetor 2025

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008) dhe Statutin e Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, si dhe në Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2025, paraqesim raportin vjetor të punës së Kuvendit dhe dy Komiteteve obligative të Kuvendit (Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit të Komuniteteve) për periudhën Janar - Dhjetor 2025.

Sa mbledhje ka mbajtur Kuvendi i Komunës gjithsej?

Emri i Komunës	Mbledhje rregullta	Mbl. Jashtëzakonshme	Mbl. urgjente	Mb. solemne
DEÇAN	9	0	0	5


Kuvendi i Komunës së Deçanit në periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka miratuar 34 vendime, si në listat e prezantuara në vijim:

Lista e vendimeve të muajit Shkurt 2025

- 1.Vendim për miratimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2025
- 2.Vendim për miratimin e Planit të punës së KKSBB-së për vitin 2025,
- 3.Vendim për miratimin e Listës me emra rezervë të rrugëve të Komunës së Deçanit,
- 4.Vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024-2032;
(Rishqyrtim i Vendimit të dt.30.12.2024)

Lista e vendimeve të muajit Mars 2025

- 1.Vendim për ndarjen e parcelës për ndërtimin e Njësive të reja banesore për Banim Social dhe Banim të Përbalueshëm në Deçan,
- 2.Vendim për ndarjen e parcelës për ndërtimin e një objekti për nevojat e Këshillit të Bashkësisë Islame (KBI) në Deçan,
- 3.Vendim për ndarjen e hapësirës për ndërtimin e objektit për nevoja të komunitetit të fshatit Llukë e Epërme.



- 4.Vendim për shpalljen e pronës me interes publik parcela nr.00094-0 dhe iniciimi procedurës së shpronësimit,
- 5.Vendim për shpalljen "QYTETAR NDERI" i Komunës së Deçanit, Gjeneralin Amerikan, Gjeneral Brigade shtz.ARTHUR GARFFER.
- 6.Vendim për miratimin e Listës Rezervë me emrat e rrugëve të Aprovuara sipas fshatrave në Komunën e Deçanit
(Rishqyrtim i Vendimit 01.Nr.I-7 të dt.27.02.2025).

Lista e vendimeve të muajit Prill 2025

- 1.Vendim për rritjen e buxhetit komunal të vitit 2024 nga të hyrat vetanake të vitit 2024;
- 2.Vendim për bartje të hyrave vetanake nga viti paraparak 2024 në vitin aktual fiskal 2025
- 3.Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01.Nr.II-5, dt. 28.02.2018 për hapjen e rrugës së re që lidhë rrugën "Himë Mushkolaj-Haxhi Mushkolaj" në qytetin e Deçanit;
- 4.Vendim për Ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01.Nr.I-11 dt.31.01.2018 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

Lista e vendimeve të muajit Maj 2025

- 1.Vendim për pagesën e Kryetarëve të Këshillave të fshatrave;
- 2.Vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, Kolonel, Todd Jacobus
- 3.Vendim për shpalljen "Qytetar Nderi" i Komunës së Deçanit, gazetarit të shquar e Udhëheqësit të emisioneve "Gjurmë shqiptare", z.Marín Mema

Lista e vendimeve të muajit Qershor 2025

- 1.Vendim për miratimin Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028,
- 2.Vendim për miratimin në parim për vënie në konsultim publik të Draft-Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025 – 2035
- 3.Vendim për ndarjen e parcelës për ndërtimin e objektit për nevojat e Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, dega në Deçan;

- 4.Vendim për miratimin në parim për vënie në konsultim publik të Draft-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale;
- 5.Vendim për ndarjen e mjeteve financiare si participim me Kompaninë Rajonale të Ujitjes KRU"Drini i Bardhë"SH.A.Pejë në projektin e përbashkët për pastrimin sezonal të kanaleve të ujitjes në territorin e komunës së Deçanit.

Lista e vendimeve të muajit Korrik 2025

- 1.Vendim për miratimin Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale
- 2.Vendim për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025 – 2035
- 3.Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 30,000.00 euro për Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Deçanit, NPL "Higjiena" dhe Fondacionit CNVP, për instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore me bazë biomasën,
- 4.Vendim për Formimin e Komisionit për ndarjen e bursave për studentë
- 5.Vendim për Formimin e Komisionit të ankesave në procesin e ndarjes së bursave për studentë,
- 6.Vendim për Shfuqizimin e Vendimit për ndarjen e parcelës për ndërtimin e Njësive të reja banesore për Banim Social dhe Banim të Përballueshëm në Deçan.

Lista e vendimeve të muajit Shtator 2025

- 1.Vendim për miratimin e Buxhetit për vitet 2026-2028,
- 2.Deklaratë mbështetëse për Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë
- 3.Vendim për miratimin Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale (Rishqyrtim i Vendimit të dt.31.07.2025).

Lista e vendimeve të muajit Dhjetor 2025

- 1.Vendim për zgjedhjen e Kryetarit të Komunës së Deçanit
- 2.Vendim për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Deçanit

Komiteti për Politikë dhe Financa-KPF për periudhën Janar – Dhjetor ka mbajtur 9 mbledhje (8 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje e jashtëzakonshme), në të cilat janë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës që kanë qenë temë shqyrtimi në mbledhjet rregullta të Kuvendit, për të cilat janë nxjerrë Rekomandimet dhe janë prezantuar në mbledhje të Kuvendit, në kopje fizike çdo anëtar i të kuvendit.

KPF ka shqyrtuar kërkesat financiare që binë në kompetencë të KPF-së sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të cilat ka nxjerrë këto vendime:

1. VENDIM PËR NDARJEN E 5.000 EURO PËR TRAJTIM MJEKËSORË TË ENDRIT JANUZAJ, dt.25.02.2025.
2. VENDIM PËR NDARJEN E 1500 EURO PËR AKTIVITETIN "N' CARRABREG DHURON GJAK 2025" dt.28.04.2025.
3. VENDIM PËR NDARJEN E 5.000 EURO PËR TRAJTIM MJEKËSORË TË BLEND DODAJ NGA FSHATI BABALLOQ, dt.28.04.2025.
4. VENDIM PËR NDARJEN E 5.000 EURO PËR NDËRTIMIN E SHTËPISË SË PËRBASHKËT PËR NEVOJA TË KOMUNITETIT TË FSHATIT LLUKË E EPËRME, dt.28.04.2025,
5. VENDIM PËR NDARJEN E 4.500 EURO PËR RREGULLIMIN E RRUGËS SË BJESHKËS SË MILISHEVCIT dt.10.07.2025.
6. VENDIM PËR NDARJEN E 4.600 EURO PËR NGRITJEN E NJË MURALI NË FSHATIN ISNIQ KUSHTUAR USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, dt.10.07.2025.
7. PËR NDARJEN E 5,000.00 EURO PËR OBJEKTIN E DJEGUR TË PUNËTORISË SË MUSA DODAJ NGA FSHATI IRZNIQ, dt.28.07.2025.
8. PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT ME QENDRËN PËR MIRËQENIEN E GRUAS-PEJË, dt.28.07.2025.

Komiteti i Komuniteteve në vitin 2025 ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta.

Anëtarët e Komitetit të Komuniteteve gjatë kësaj kohe disa herë kanë dalë në teren ku kanë vizituar komunitetet jo shumicë që jetojnë në Komunën e Deçanit, ku janë njoftuar për së afërmi me nevojat dhe kërkesat e tyre, të cilat i kanë adresuar te ekzekutivi i komunës për shqyrtim dhe miratim.

Ligji për vetëqeverisje lokale përkatësisht neni 68 i tij përcakton se komuna brenda një viti mbanë dy takime publike, njëri në 6 mujin e parë dhe i dyti në gjashtëmujin e dytë.

Komuna e Deçanit ka mbajtur takimin e parë publik me qytetar për gjashtë mujin e parë, me dt.15 korrik 2025, në të cilin takim ka raportuar Kryetari i Komunës, ndërsa për gjashtë mujin e dytë ka mbajtur takimin e dytë publik me dt.30 Dhjetor 2025 (e Marte), ku ka raportuar Kryetari i Komunës si dhe qytetarët e pranishëm në sallë, në fjalën e tyre kanë paraqitur kërkesat e tyre, si dhe vlerësimet për çështjet e ndryshme që i preokupojnë qytetarët, është debatuar për ofrimin e shërbimeve cilësore komunale dhe për çështjet lidhur me realizimin e synimeve programore të komunës gjatë vitit 2025.

Komunat janë të obliguara të mbajnë edhe takime publike për miratimin e rregulloreve apo buxhetet komunale.

Kuvendi i Komunës së Deçanit gjatë vitit 2025 ka organizuar takime publike për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore(KAB), Buxhetit Komunal, rregulloreve, Planeve, të cekura më poshtë:

Numri i takimeve publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB).

1.KOMUNA E DEÇANIT KA MBAJTUR TAKIMIN PUBLIK PËR KAB 2026-2028 ME DT.19.06.2025.

Numri i dëgjimeve buxhetore për buxhetin vjetor komunal.

- Komuna e Deçanit ka organizuar 8 dëgjime buxhetore për Projekt-Buxhetin 2026-2028, në këto orare:

1.DËGJIMIN E PARË BUXHETOR

Për PROJEKT-BUXHETIN 2026-2028 GRANTI SPECIFIK PËR ARSIM
Dëgjimi buxhetor është mbajtur me dt. 29.07.2025(e Marte) në ora 10:00

2.DËGJIMIN E DYTË BUXHETOR

Për: PROJEKT-BUXHETI 2026-2028 GRANTI SPECIFIK PËR SHËNDETËSI
Dëgjimi buxhetor është mbajtur me dt. 29.07.2025(e Marte) në ora 11:00

3.DËGJIMIN E TRETË BUXHETOR ME OJQ, RININË DHE SPORTISTËT E KOMUNËS SË DEÇANIT

Tema: PROJEKT-BUXHETI 2026-2028

Dëgjimi buxhetor është mbajtur me dt. 01.08.2025(e Premte) në ora 10:00

4.DËGJIMIN E KATËRT BUXHETOR ME KRYETARËT E KËSHILLAVE LOKALE

Tema: PROJEKT-BUXHETI 2026-2028

Dëgjimi buxhetor është mbajtur me dt. 01.08.2025(e Premte) në ora 11:00

5. DËGJIMIN E PESTË BUXHETOR ME GRATË E KOMUNËS SË DEÇANIT

Tema: PROJEKT-BUXHETI 2026-2028

Dëgjimi buxhetor është mbajtur me dt. 04.08.2025(e Hënë) në ora 10:00

6. DËGJIMIN E GJASHTË BUXHETOR ME PËRFAQËSUES TË KOMUNITETEVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

Tema: PROJEKT-BUXHETI 2026-2028

Dëgjimi buxhetor është mbajtur me dt. 04.08.2025(e Hënë) në ora 11:00

7.DËGJIMIN E SHATATË BUXHETOR

ME TË GIITHË QYTETARËT E KOMUNËS SË DEÇANIT

Tema: PROJEKT-BUXHETI 2026-2028

Dëgjimi buxhetor është mbajtur me dt. 05.08.2025(e Martë) në ora 11:00

8.DËGJIMIN E TETË BUXHETOR (KPF) NË SALLËN E KUVENDIT I HAPUR ME TË GIITHA PALËT E INTERESIT

Tema: PROJEKT-BUXHETI 2026-2028

Dëgjimi buxhetor është mbajtur me dt. 16.09.2025(e Martë) në ora 11:00

Miratimi i Buxhetit nga Kuvendi i Komunës para datës 30 shtator.

- Kuvendi i Komunës së Deçanit ka miratuar buxhetin për vitin 2026, me dt.29 Shtator 2025.

Numri i organizimit të konsultimeve publike për miratimin e Akteve të përgjithshme në Kuvendin komunal, për të cilat është organizuar konsultim me publikun.

1.KONSULTIM PUBLIK Për : DRAFT – STATUTIN E QKMF-së

Data: 25 Prill 2025 (e Premte)

2.KONSULTIM PUBLIK PËR DRAFT – RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN KOMUNALE.

Data: 17 Korrik 2025 (e Enjte)

Deçan.dt.28.01.2026

Raport i përgatitur nga:

Udhëheqëse e Sektorit për Punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit

Dyke HOLLUNI

